

Data 12.09.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje bojra teknologjike dhe lëndë pastrimi teknologjike për Hibrid Mail”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 30125110-5
Toner per printer lazer/makina fax.**

VLERA E FONDIT LIMIT:

22,220,975 (njëzet e dy milion e dyqind e njëzet e dy të mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH

Në Eur : 223,934.04 (dyqind e njëzetë e tre mijë e nëntëqind e tridhjetë e katër pikë zero katër) Euro, pa TVSH

Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 12.09.2024 është 99.23 Lekë/Euro

Në bazë të nenit 39, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” date 23.12.2020, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor “Posta Shqiptare” SH.A. ka vendosur qe kjo procedure te mos jete ne lote sipas arsyetimit te meposhtem:

Kjo kontratë nuk është ndarë në lote pasi administrimi i saj, pra i gjithë bazës materiale objekt kontrate do të administrohet nga Drejtoria e Përgjithshme Posta Shqiptare SH.A, si dhe ndjekja dhe zbatimi i kontrates do të jetë në makinerinë e Filialit Hibrid Mail, ndarja dhe frangmentimi i saj do të krijonte kompleksitet dhe vështirësi në zbatim si dhe do e bënte të pazbatueshme kontratën.

Objekti i kontrates lidhet me furnizimin e **blerjes së bojrave teknologjike dhe lëndë pastrimi teknologjike për Hibrid Mail**”, janë bojra të cilat janë të nevojshme për makinerin e printimit të Filialit Hibrid Mail e cila punon vetëm me këto bojra.

Përsa më lart ndarja në lote do ta ndërlikonte dhe vështirësonte procesin e zbatimit të kontratës duke krijuar vonesa dhe rrjedhimisht do sillte vështirësi për stafin kërkues të bazës materiale. Kjo kontrate nuk mund të ndahet në lote pasi në thelb të gjithë artikujt objekt i kontratës i përkasin të njëjtës kategori produktesh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (ndryshuar), autoriteti/enti kontraktor **Posta Shqiptare sh.a.**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe nenit

.....
(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore financiare të 3 (tre) viteve të fundit, **ku të paktën në njerin nga këto tre vite të ketë realizuar një xhiro minimale vjetore me vlerë jo më pak se 99% të vlerës limit të kontratës që prokurohet.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

(Kërkesa e lartpërmëndur do i shërbejë autoritetit kontraktor si tregues për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Kjo në përputhje me nenin 77 të LPP dhe nenin 43 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”).

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore": "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më e vogël se **39%** e vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenin nenin 55, pika 4/b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është nën kufirin e ulët monetar. Vlera për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme të ngjashme, përbën një nivel të mjaftueshëm përvoja duke patur parasysh objektin dhe vlerën e kontratës.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdosshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2 Operatori ofertues duhet të deklarojë në ofertë se: Materialet teknologjike të pastrimit dhe bojrat teknologjike objekt kontrate, janë origjinale dhe se mban përgjegjësi të plotë juridike dhe financiare në rast të dëmtimit të pajisjes nga mospërputhshmëria e materialeve të ofertuara.

Argumentimi: *Makineria e printimit të Filialit Hibrid Mail punon vetëm me bojrat e listuara në specifikimet teknike dhe jo me ekuivalente të këtyre bojrave. Si rrjedhojë, për funksionimin normal të makinerisë së Filialit Hibrid Mail, OE që paraqitet në tender, duhet të marrë përsipër ofrimin e bojrave dhe materialeve të pastrimit të përcaktuara në DST.*

2.3.3 Afati i garancisë së produkteve duhet të jetë jo më pak se 1 (një) vit nga data e lëvrimit të mallit. Bojrat të jenë të pajisura me element verifikimi QR-Code ose ekuivalent.

Argumentimi: *Kontrata do të lidhet me afta 1 vjeçar, si rrjedhojë, afati i garancisë së produkteve nuk mund të jetë më i shkurtër se një vit nga data e lëvrimit të mallit. Gjithashtu, QR-Code, është i nevojshëm për verifikimin e të dhënave të produktit.*

2.3.4 Operatori Ekonomik në datën dhe orën e hapjes së ofertave duhet të paraqesë dorazi mostra/modele për secilin nga produktet e përcaktuara në sasinë dhe grafikun e lëvrimit dhe sipas specifikimeve teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor. OE do të dorëzojë mallrat dhe do të paraqitet për të marrë pjesë në vlerësimin e cilësisë së produkteve dhe testimin e tyre në pajisje. Procedura e vlerësimit do të bëhet në një moment të dytë me kërkesë dhe njoftim të AK ku do të jetë prezent edhe një përfaqësues i OE.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 6/a nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë dëshmojnë se tonerat të jenë sipas kërkesave dhe në përmbushje të specifikimeve teknike.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatë ISO 14001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalente. Certifikatat ISO duhet të jenë lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë

Argumentimi: Certifikata e menaxhimit të mjedisit **ISO 14001:2015** ose ekuivalente, ka të bëjë me manaxhimin mjedisor, i cili përfaqëson kalimin e drejtimit të kompanisë dhe respektimin e ligjeve, në një manaxhim të aktivitetit përkushtuar parandalimit të ndotjes dhe të përmirësimit të ndikimeve mjedisore. Mbrojtja e mjedisit ka për çdo kompani një rol gjithmonë e më të rëndësishëm. Sistemi i menaxhimit mjedisor në këtë objekt është i domosdoshëm pasi ndotja e ajrit nga makineritë e printimit do të vinte në vështirësi dhe do të bëhej burim sëmundje / ndotje akustike.

Referuar objektit të prokurimit, Njësia e Prokurimit gjykon se është e nevojshme që shoqëritë të jenë të certifikuara nga organizata ndërkombëtare të cilat garantojnë një nivel të pranuar të menaxhimit të mjedisit sa kohë që veprimtaria e tyre ka ndikim të drejtpërdrejtë mbi të. Dhe duhet të aplikojnë disa standarte sigurie lidhur me mbrojtjen e mjedisit, të cilat garantojnë nga certifikimi i tyre nga organizma ndërkombëtare.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.**

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë, për blerjet e reja cilësore, kërkesat aktuale për funksionalitet zgjerim cilësi e performancë si dhe shërbimet profesionale të migrimit të kërkuara për teknologjite ekzistuese, sipas objektit të procedurës së prokurimit, duke përllogaritur mënyrën e ofrimit të produkteve të reja (përfshirë virtualizimin) dhe shërbimeve të migrimit, karakteristikat e duhura bashkëkohore teknologjike, standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, duke pasur parasysh garancitë përkatëse të këtyre sistemeve, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Në çdo rast ku ka qenë e mundur është përdorur termi “ose ekuivalent” për të qenë gjithmonë në konformitet me zbatimin e legjislacionit të prokurimeve publike dhe akteve nën-ligjore në zbatim të tyre.

Nr	Përshkrimi i Mallit	Njësia	Sasia
1	VarioPrint Océ i200 Series Ink Cyan	Kg	450
2	VarioPrint Océ i200 Series Ink Magenta	Kg	450
3	VarioPrint Océ i200 Series Ink Yellow	Kg	230
4	VarioPrint Océ i200 Series Ink Black	Kg	530
5	Alkohol etilik 90 gradë	Litër	300
6	PML Océ VarioPrint i200	Litër	180
7	Ngjithës për pajisjen e performimit	Litër	1125
8	Rribons për pastrimin e VarioPrint i200 i set * 40 copë	Set	6

***Shënim:** Makineria e printimit të Filialit Hibrid Mail punon vetëm me këto bojra dhe jo me ekuivalent të këtyre bojrave. Në kushtet e tenderimit, bojrat të provohen në makineri.

Lidhur me përcaktimin në shtojcën e specifikimeve teknike ku thuhet se: “Makineria e printimit të Filialit Hibrid Mail punon vetëm me këto bojra dhe **jo me ekuivalent** të këtyre bojrave. Në kushtet e tenderimit, bojrat të provohen në makineri”, si dhe me pikën pikën **2.3.2** të kapacitetit teknik “Operatori ofertues duhet të deklarojë në ofertë se: **Materialet teknologjike të pastrimit dhe bojrat**

teknologjike objekt kontrate, janë origjinale dhe se mban përgjegjësi të plotë juridike dhe financiare në rast të dëmtimit të pajisjes nga mospërputhshmëria e materialeve të ofertuara”, sqarojmë si më poshtë vijon:

Sipas direktivave të prodhuesit Canon-Oce, të gjitha lëndët e para dhe pjesët e konsumit të pajisjes Oce VarioPrint I200, duhet të jenë origjinale dhe brenda aftit të skadencës, kjo e verifikueshme me QR Code/Nr. Serial, apo duke kontaktuar prodhuesin.

Nëse konstatohet përdorimi i lëndëve, jo të certifikuara nga prodhuesi nuk mund të ofrohet shërbim në vazhdimësi për pajisjen pasi pajisja humbet suportin nga prodhuesi dhe mundësinë për të aktivizuar kontratën e mirëmbajtjes. Një pajisje e tillë është e pamundur të mirëmbahet nga ndonjë OE pa patur support nga prodhuesi.

Arsyetimi teknik

Disa nga sistemet që preken në rast të përdorimit të lëndëve të pacertifikuara janë:

1. Automatic Inline Color Calibration

Ky opsion monitoron në mënyrë dinamike gjatë printimit cilësinë e imazhit dhe një ndryshim minimal në pigmentim nxjerr scarco të gjitha materialet. Për më tepër makineria mund të bllokohet nga kodi “Calibration Error”.

2. Automatic Printhead Cleaning/Purging

Ky opsion pastron kokat e shkrimit duke përdorur bojën, PML dhe EML. Përdorimi i lëndëve jo origjinale përveçse është i pamundur pasi pajisja nuk i njeh (për shkak të QR Code shpjeguar më sipër), por do të dëmtonte dhe kokat e printimit në rast se do të tentohej të manipulohet me QR Code-t.

3. Rreziku i dëmtimit/bllokimit të kokave të shkrimit në terma afatgjatë (Nozzle clogging)

Kostoja e ndërrimit apo riparimit të kokave të shkrimit në rast dëmtimi apo bllokimi është relativisht e lartë. Në rast të përdorimit të lëndëve të pacertifikuara, përgjegjësia mbetet totalisht te AK pasi siç është përmendur më sipër, prodhuesi Canon-Oce ndalon përdorimin e lëndëve të pacertifikuara në pajisje.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike të procedurës për Specifikimet teknike të procedurës për **“Blerje bojra teknologjike dhe lëndë pastrimi teknologjike për Hibrid Mail”**, janë hartuar mbi bazën e **Urdhërit Nr. 58**, datë **01.07.2024**, të Administratorit të Posta Shqiptare sh.a., në përputhje me nenin 4, pika 38/b dhe nenin 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (ndryshuar).

Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

VLERA LIMIT E KONTRATËS,

Vlera Limit e kontratës, duke qenë se nuk ka çmime të botuara nga INSTAT-i, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse, grupi i punës i ngritur me urdhërin e administratorit **nr. 73**, datë **27.08.2024**, u bazua në çmimet e tregut, e bazuar në nenin 76

“Mënyrat për përlogaritjen e vlerës së prokurimit”, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimeve Publike” (i ndryshuar) ku parashikohet se:

1. Në përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:

- a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe*
- b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe*
- c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe*
- ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.*

Autoriteti/enti kontraktor mund t’i referohet një ose më shumë alternativave të mësipërme në përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

*Bazuar në germen b) të pikes 1, të nenit 76 “Mënyrat për përlogaritjen e vlerës së prokurimit”, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimeve Publike” (i ndryshuar), grupi i punës, ka realizuar **studimin e tregut**, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; dokumentacion i cili gjendet në dosjen e tenderit dhe ka përlogaritur vlerën limit të kontratës.*

Specifikimet teknike fondi limit dhe kriteret e vecanta për kualifikim janë hartuar nga strukture e posacme e ngritur me urdhër të titullarit të autoritetit kontraktor.

Njësia e Prokurimit: